| 86            | Avokati i Prokurimeve                                       | 23.000                 | 0                   | 0               | 0                 | 0                      | 23.000                         |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                     | 23.000                 | 0                   | 0               | 0                 | 0                      | 23.000                         |
| 87            | Institucione të tjera Qeveritare                            | 658.596                | 326.500             | 0               | 0                 | 326.500                | 985.096                        |
| 01320         | Shërbime Qeveritare                                         | 59.500                 | 30.000              | 0               | 0                 | 30.000                 | 89.500                         |
| 01130         | Shërbimi i Prokurimit Publik                                | 70.532                 | 9.000               | 0               | 0                 | 9.000                  | 79.532                         |
| 01140         | Shërbime për Shoqërinë e Informacionit                      | 337.470                | 184.000             | 0               | 0                 | 184.000                | 521.470                        |
| 01150         | Shërbime të tjera                                           | 109.824                | 63.500              | 0               | 0                 | 63.500                 | 173.324                        |
| 01510         | Shërbime për Teknologjinë dhe Inovacionin                   | 81.270                 | 40.000              | 0               | 0                 | 40.000                 | 121.270                        |
| 88            | Mbështetje për Shoqërinë Civile                             | 115.400                | 1.500               | 0               | 0                 | 1.500                  | 116.900                        |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                     | 115.400                | 1.500               | 0               | 0                 | 1.500                  | 116.900                        |
| 89            | Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale            | 41.100                 | 1.000               | 0               | 0                 | 1.000                  | 42.100                         |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                     | 41.100                 | 1.000               | 0               | 0                 | 1.000                  | 42.100                         |
| 91            | Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi                  | 31.200                 | 2.000               | 0               | 0                 | 2.000                  | 33.200                         |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                     | 31.200                 | 2.000               | 0               | 0                 | 2.000                  | 33.200                         |
| 92            | Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit              | 25.700                 | 100                 | 0               | 0                 | 100                    | 25.800                         |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                     | 25.700                 | 100                 | 0               | 0                 | 100                    | 25.800                         |
| 93            | Ministria e Energjisë dhe Industrisë                        | 242.700                | 71.300              | 0               | 192.645           | 263.945                | 506.645                        |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                     | 28.200                 | 0                   | 0               | 0                 | 0                      | 28.200                         |
| 04320         | Mbështetje për Energjinë                                    | 11.000                 | 24.400              | 0               | 100.000           | 124.400                | 135.400                        |
| 04430         | Mbështetje për Burimet Natyrore                             | 203.500                | 46.900              | 0               | 92.645            | 139.545                | 343.045                        |
| 94            | Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit                   | 963.541                | 196.000             | 0               | 966.513           | 1.162.513              | 2.126.054                      |
| 01110         | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                     | 27.400                 | 0                   | 0               | 0                 | 0                      | 27.400                         |
| 06180         | Planifikimi Urban dhe Strehimi                              | 666.200                | 165.000             | 0               | 466.513           | 631.513                | 1.297.713                      |
| 06220         | Menaxhimi i Mbetjeve Urbane                                 | 179.300                | 31.000              | 0               | 500.000           | 531.000                | 710.300                        |
| 04760         | Zhvillimi i Turizmit                                        | 90.641                 | 0                   | 0               | 0                 | 0                      | 90.641                         |
| <b>TOTALI</b> |                                                             | <b>189.765.895</b>     | <b>36.579.934</b>   | <b>19.000</b>   | <b>39.884.474</b> | <b>76.483.408</b>      | <b>266.249.303</b>             |



**UDHËZIM**  
**Nr. 3, datë 2.12.2013**

**PËR DOKUMENTACIONIN E DOMOSDOSHËM PËR TË KËRKUAR LEJE MJEDISORE**  
**TË TIPIT A, B DHE C PËR AKTIVITETE TË REJA DHE EKZISTUESE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”,

**UDHËZOJ:**

1. Për t’u pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B për aktivitete të reja me ndikim në mjedis, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, përgatisin dokumentet që kërkohen nga ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe ligji nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Dokumentet konsistojnë në:

1.1 Dokumentacionin ligjor, që përbëhet nga:

Originali ose fotokopje e noteruar e aktit të regjistrimit të subjektit në regjistrin tregtar;

1.2 Dokumentacioni teknik (përshkrimi i aktivitetit, skica, harta etj.), që përbëhen nga:

a) Karakteristikat e projektit:

- përshkrimi i teknologjisë, proceseve kryesore, kapaciteti, lëndët e para, energjia, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;

- program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;

- aktivitete të tjera që mund të kërkohen si pasojë e projektit (p.sh.: rrugë të reja, sigurim i ujit të pijshëm etj.).

b) Vendndodhja e projektit:

- planimetria me kufijtë hapësinorë të projektit;

- harta të shoqëruara me koordinatat dhe fotografi që tregojnë vendndodhjen e projektit;

- planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.

c) Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të hartuar nga ekspertë të certifikuar e të përzgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore. Raportet e VNM-së të firmosen dhe të vulosen nga hartuesit, si dhe të jepen të dhënat e licencës së ekspertëve të mjedisit, të certifikuar nga Ministria e Mjedisit ose subjekte juridike/fizike tregtare të licencuara nga QKL-ja (emrin, numrin e regjistrimit, datën e miratimit dhe numrin e vendimit të certifikatës). Në rast se raporti i VNM-së hartohet nga studioja, raporti i VNM-së të firmoset nga ekspertët e certifikuar nga Ministria e Mjedisit (emrin, numrin e regjistrimit, datën e miratimit dhe numrin e vendimit të certifikatës), përveç certifikatës së subjektit juridik/fizik tregtar të licencuar nga QKL-ja.

Raporti i VNM-së të shoqërohet edhe me kopje të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të ekspertit/studios që ka hartuar raportin e VNM-së.

d) Informacion me të dhëna të konsultimit me publikun, përfaqësues të pushtetit vendor, përfaqësues të Agjencisë Rajonale të Mjedisit dhe palët e interesuara sipas legjislacionit në fuqi. Bashkëngjitur informacionit të jenë: procesverbale të takimeve, materialet e prezantuar, lista e personave të pranishëm, foto, që provojnë komunikimet e kërkuesit me publikun e zonës.

e) Plani i rehabilitimit për veprimtaritë që shfrytëzojnë burimet minerare. Plani i rehabilitimit hartohet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

f) Njoftimin e fituesit të konkurrimit publik nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zhvillimin e aktivitetit për veprimtaritë që shfrytëzojnë burimet minerare në zona konkurruese, zona të hapura apo zona koncensionare.

g) Plani i përballimit të emergjencave për veprimtaritë që përdorin, prodhojnë dhe magazinon (depozitim) lëndë të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve (si karburantet) apo substancat dhe preparatet të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

h) Përmbledhjen joteknike (në gjuhë dhe terminologji lehtësisht të kuptueshme) të raportit të VNM-së, i cili përmban informacion të përmbledhur për çdo çështje të trajtuar në raportin e VNM-së. Për lehtësi praktike, dokumenti duhet të dorëzohet edhe elektronikisht në format PDF.

1.3 Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit për lejen mjedisore sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës.

2. Për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit C, për aktivitete të reja me ndikim në mjedis, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, përgatisin dokumentet që kërkohen nga ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe ligji nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis". Dokumentet konsistojnë në:

2.1 Dokumentacionin ligjor, që përbëhet nga:

Originali ose fotokopje e noteruar e aktit të regjistrimit të subjektit në regjistrin tregtar;

2.2 Dokumentacioni teknik (përshkrimi i aktivitetit, skica, harta etj.), që përbëhen nga:

a) Karakteristikat e projektit:

- përshkrimi i teknologjisë, proceseve kryesore, kapaciteti, lëndët e para, energjia, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;

- program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;

- aktivitete të tjera që mund të kërkohen si pasojë e projektit (p.sh.: rrugë të reja, sigurim i ujit të pijshëm etj.).

b) Vendndodhja e projektit:

- planimetria me kufijtë hapësinorë të projektit;

- harta të shoqëruara me koordinatat dhe fotografi, që tregojnë vendndodhjen e projektit;

- planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.

c) Raportin e përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të hartuar nga ekspertë të certifikuar e të përzgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore. Raportet e VNM-së të firmosen dhe të vulosen nga hartuesit, si dhe të jepen të dhënat e licencës së ekspertëve të mjedisit të certifikuar nga Ministria e Mjedisit ose subjekte juridike/fizike tregtare të licencuara nga QKL-ja (emrin, numrin e regjistrimit, datën e miratimit dhe numrin e vendimit të certifikatës). Në rast se raporti i VNM-së hartohet nga studioja, raporti i VNM-së të firmoset nga ekspertët e certifikuar nga Ministria e Mjedisit (emrin, numrin e regjistrimit, datën e miratimit dhe numrin e vendimit të certifikatës), përveç certifikatës së subjektit juridik/fizik tregtar të licencuar nga QKL-ja.

Raporti i VNM-së të shoqërohet edhe me kopje të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të ekspertit/studios që ka hartuar raportin e VNM-së.

d) Informacion me të dhëna të konsultimit me publikun dhe palët e interesuara sipas legjislacionit në fuqi. Bashkëngjitur informacionit të jenë: procesverbale të takimeve, materialet e prezantuara, lista e personave të pranishëm, foto, që provojnë komunikimet e kërkuesit me publikun e zonës.

e) Përmbledhjen joteknike (në gjuhë dhe terminologji lehtësisht të kuptueshme) të raportit të VNM-së, i cili përmban informacion të përmbledhur për çdo çështje të trajtuar në raportin e VNM-së. Për lehtësi praktike, dokumenti duhet të dorëzohet edhe elektronikisht në format PDF.

2.3 Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit për lejen mjedisore sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës.

3. Për t'u ripajisur me leje mjedisore të tipit A, B dhe C, për aktivitete ekzistuese me ndikim në mjedis, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, përgatisin dokumentet që kërkohen nga ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit". Dokumentet konsistojnë në:



3.1 Dokumentacionin ligjor, që përbëhet nga:

Origjinali ose fotokopje e noteruar e aktit të regjistrimit të subjektit në regjistrin tregtar;

3.2 Dokumentacioni teknik (përshkrimi i aktivitetit, skica, harta etj.), që përbëhen nga:

a) Karakteristikat e projektit:

- një relacion të shkurtër për veprimtarinë e pajisur me leje mjedisore/leje të thjeshtë mjedisore dhe aktivitetet që ajo kryen, përshkrimi i teknologjisë, proceseve kryesore, kapaciteti, lëndët e para, energjia, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;

- program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;

- aktivitete të tjera që mund të kërkohen si pasojë e projektit (p.sh.: rrugë të reja, sigurim i ujit të pijshëm etj.).

b) Vendndodhja e projektit:

- planimetria me kufijtë hapësinorë të projektit;

- harta të shoqëruara me koordinatat dhe fotografi që tregojnë vendndodhjen e projektit;

- planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.

c) Një informacion për masat e marra për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore;

d) Në rast se në kushtet e lejes mjedisore/lejes së thjeshtë mjedisore kërkohet rehabilitim mjedisor, të paraqitet informacion për punimet rehabilituese që janë realizuar;

e) Për veprimtaritë me shkarkime në mjedis, të paraqiten rezultatet e vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis për një periudhë pararendëse 1-vjeçare që nga data e paraqitjes së kërkesës pranë QKL-së, të shoqëruar me emrin e subjektit që ka kryer matjen, mënyra e marrjes së mostrës së analizuar, instrumentin matës dhe mënyrën/metodën e analizimit të mostrës.

3.3 Fotokopjen e lejes mjedisore/lejes së thjeshtë mjedisore ekzistuese që subjekti posedon edhe në rastet kur i ka mbaruar afati i ripërtëritjes;

3.4 Të dhëna të mbajtësit të lejes, emërtimi, adresa, personin e kontaktit dhe mënyrën e kontaktit (telefon, e-mail etj.).

4. Deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, do të zbatohen këto procedura:

a) Leja e tipit C, e parashikuar në ligjin nr. 10448/2011, do të trajtohet si leje e nënkategorisë “Leje e thjeshtë mjedisore” me kodin III.1.A, e parashikuar në aneksin I të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar, por do të quhet “Leja e tipit C”.

b) Leja e tipit B, e parashikuar në ligjin nr. 10448/2011, do të trajtohet si leje e nënkategorisë “Leje mjedisore” me kodin III.1.B, e parashikuar në aneksin I të VKM-së nr. 538/26.5.2009, por do të quhet “Leja e tipit B”

c) Leja e tipit A, e parashikuar në ligjin nr. 10448/2011, do të trajtohet si leje e nënkategorisë “Leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C, e parashikuar në aneksin I të VKM-së nr. 538/26.5.2009, por do të quhet “Leja e tipit A”.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe agjencitë rajonale të mjedisit për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 4, datë 15.4.2013 “Për dokumentacionin e aplikimit për leje mjedisi të tipit A, B dhe C në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL)”, i ministrit të Mjedisit shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT  
**Lefter Koka**

**URDHËR**  
**Nr. 1212, datë 13.11.2013**

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË REGJISTRAVE TË SUBJEKTEVE QË GJENEROJNË,  
GRUMBULLOJNË DHE RICIKLOJNË VAJRA TË PËRDORURA**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 27 dhe 66 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruat të mbetjeve” dhe të vendimit nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” të Këshillit të Ministrave,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorura, sipas modeleve bashkëlidhur këtij urdhri:

1.1 Librin e regjistrit për prodhuesit dhe importuesit e vajrave lubrifikante.

1.2 Librin e regjistrit për gjeneruesit e mbetjeve vajore.

1.3 Librin e regjistrit për menaxhuesit e licencuar të grumbullimit dhe riciklimit të vajrave lubrifikante të përdorura.

1.4 Etiketën “ruajtjen në ambalazh të veçantë” për grumbulluesit e vajrave lubrifikante të përdorura.

1.5 Dokument për marrjen në dorëzim të mbetjeve vajore.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit për Mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve, agjencitë rajonale të mjedisit në qarqe dhe lidhur me procedurën e botimit në Fletoren Zyrtare, si dhe procedurën përkatëse të prokurimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse.

3. Urdhri nr. 204, datë 13.3.2013 “Për miratimin e modelit të regjistrave, dokumenteve dhe formateve të regjistrimit të subjekteve”, i ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, shfuqizohet.

Ky urdhër hynë në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MJEDISIT**  
**Lefter Koka**



Libri nr. \_\_\_\_\_

Libri i regjistrimit të të dhënave të vajrave lubrifikante apo industriale që importohen ose janë prodhim vendas, të cilat duhet të regjistrohen në regjistrin e miratuar nga Ministria e Mjedisit në zbatim të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 7.11.2012, si detyrim ligjor për subjektet që prodhojnë, importojnë apo shesin produktin në tregun shqiptar, duke qenë se prodhuesit e vajrave lubrifikante dhe industriale janë përgjegjës për financimin e grumbullimit, transportimit dhe trajtimit, për sasinë e minimumit të 80% të vajrave të përdorura, të sasisë së trajtuar në vit nga ana e tij, në respektim të parimit “Ndotësi paguan”.

Data: \_\_\_\_\_

Agjencia Rajonale e Mjedisit

Qarku: \_\_\_\_\_

Kryetari: \_\_\_\_\_

Emri i subjektit: \_\_\_\_\_

Prodhues i vajrave: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

NIPT-i: \_\_\_\_\_

Lloji i aktiviteti: \_\_\_\_\_

Leje mjedisore nr.: \_\_\_\_\_

Libri i regjistrimit nr.: \_\_\_\_\_

Administratori: \_\_\_\_\_

TË DHËNAT E PRODHUESVE TË VAJRAVE NGA IMPORTI OSE PRODHIMI VENDAS

| Nr. | Origjina e vajrave<br>lubrifikante dhe industriale |                | Sasia |       | Data              |                   | Blerësi  |        |        | Nr. i faturës<br>tatimore |
|-----|----------------------------------------------------|----------------|-------|-------|-------------------|-------------------|----------|--------|--------|---------------------------|
|     | import                                             | prodhim vendas | kg    | litra | data e<br>blerjes | data e<br>shitjes | subjekti | NIPT-i | adresa |                           |
| 1   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 2   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 3   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 4   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 5   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 6   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 7   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 8   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 9   |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |
| 10  |                                                    |                |       |       |                   |                   |          |        |        |                           |



### HYRJET-DALJET E TREGTUESVE DHE PIKAVE TË SHITJES

| Sasia e blerjes |              | Të dhënat e tregtuesit |        |        | Data e blerjes | Nr. i faturës tatimore të blerjes | Sasi e shitjes | Të dhënat e blerësit |        |        | Data e shitjes | Nr. i faturës tatimore të shitjes |
|-----------------|--------------|------------------------|--------|--------|----------------|-----------------------------------|----------------|----------------------|--------|--------|----------------|-----------------------------------|
| Nr.             | kg ose litra | subjekti               | NIPT-i | Adresa |                |                                   | kg ose litra   | subjekti             | NIPT-i | Adresa |                |                                   |
| 1               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 2               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 3               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 4               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 5               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 6               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 7               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 8               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 9               |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |
| 10              |              |                        |        |        |                |                                   |                |                      |        |        |                |                                   |

Libri nr. \_\_\_\_\_

Libri i regjistrimit të mbetjeve të rrezikshme, i miratuar nga Ministria e Mjedisit në zbatim të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 7.11.2012, për deklarimin e destinacionit përfundimtar të mbetjeve si detyrim ligjor për subjektet që me veprimtarinë e tyre grumbullojnë dhe riciklojnë mbetje vajore të rrezikshme, në përputhje me standardet e vendosura nga shteti shqiptar, bazuar me direktivat e Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

Data: \_\_\_\_\_

Agjencia Rajonale e Mjedisit

Qarku: \_\_\_\_\_

Kryetari: \_\_\_\_\_

Emri i subjektit: \_\_\_\_\_

Menaxhuesi i licencuar: \_\_\_\_\_

Qendra e grumbullimit dhe trajtimit: \_\_\_\_\_

NIPT-i: \_\_\_\_\_

Lloji i i aktivitetit: \_\_\_\_\_

Leje mjedisore nr.: \_\_\_\_\_

Licenca nr.: \_\_\_\_\_

Libri i regjistrimit nr.: \_\_\_\_\_

Administratori: \_\_\_\_\_



PROCESI I GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE TË RREZIKSHME VAJORE

| Nr. | Veprimtaria që gjeneron mbetjet | Emërtimi i mbetjeve dhe kodi përkatës | Sasia në kg ose litra | Data e grumbullimit | Data e depozitimit në impiant | Të dhënat e krijuesit të mbetjeve |        |        | Nr i dok.të dorëzimit | Transporti     |
|-----|---------------------------------|---------------------------------------|-----------------------|---------------------|-------------------------------|-----------------------------------|--------|--------|-----------------------|----------------|
|     |                                 |                                       |                       |                     |                               | subjekti                          | NIPT-i | adresa |                       | targa e mjetit |
| 1   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 2   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 3   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 4   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 5   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 6   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 7   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 8   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 9   |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |
| 10  |                                 |                                       |                       |                     |                               |                                   |        |        |                       |                |

PROCESI I RICIKLIMIT TË MBETJEVE TË RREZIKSHME VAJORE

| Nr. | Adresa e implantit të trajtimit | Nr. i autorizimit të implantit | Operacionet e riciklimit të mbetjeve vajore |            |       | Subjekti i dorëzimit të produktit të ri | Sasia kg ose litra | Emërtimi i produktit | Transportuesi |       |
|-----|---------------------------------|--------------------------------|---------------------------------------------|------------|-------|-----------------------------------------|--------------------|----------------------|---------------|-------|
|     |                                 |                                | data                                        | përshkrimi | sasia |                                         |                    |                      | targa         | mjeti |
| 1   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 2   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 3   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 4   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 5   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 6   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 7   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 8   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 9   |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |
| 10  |                                 |                                |                                             |            |       |                                         |                    |                      |               |       |



### DOKUMENT PER MARRJE NE DOREZIM TE VAJRAVE TE PERDORUR

(BAZUAR NE VKM NR.765, DATË \_07/11/2012 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR GRUMBULLIMIN  
E DIFERENCUAR DHE TRAJTIMIN E VAJRAVE TË PËRDORURA)

MIRATUAR NGA MINISTRIA E MJEDISIT

FATURE Nr. \_\_\_\_\_

#### TE DHENAT E SUBJEKTIT QE PRODHON V.P.

EMRI \_\_\_\_\_

NIPT

ADRESA \_\_\_\_\_

QYTETI \_\_\_\_\_

TELEFON \_\_\_\_\_

LEJA MJEDISORE \_\_\_\_\_

AKTIVITETI \_\_\_\_\_

#### TE DHENAT E SUBJEKTIT QE GRUMBULLON DHE TRAJTON V.P.

EMRI \_\_\_\_\_

NIPT

ADRESA \_\_\_\_\_

QYTETI \_\_\_\_\_

TELEFON \_\_\_\_\_

LEJA MJEDISORE \_\_\_\_\_

LICENCE \_\_\_\_\_

ADRESA (VENDI I GRUMBULLIMIT) \_\_\_\_\_

ADRESA (VENDI I TRAJTIMIT) \_\_\_\_\_

| DATA E<br>NGARKIMIT | ORA E<br>NGARKIMIT | VENDI I<br>NGARKIMIT | KODI I<br>MBETJEVE | EMERTIMI I<br>MBETJEVE | SASIA       | MJETI I TRANSPORTIT |        |
|---------------------|--------------------|----------------------|--------------------|------------------------|-------------|---------------------|--------|
|                     |                    |                      |                    |                        | LITRA / TON | MARKA               | TARGAT |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |
|                     |                    |                      |                    |                        |             |                     |        |

DOREZUESI

EMER, MBIEMER, NENSHKRIM, VULE


\_\_\_\_\_

MARRESI

EMER, MBIEMER, NENSHKRIM, VULE

\_\_\_\_\_

# VETËM VAJ I PËRDORUR



**RREZIK TOKSIK**

HELMUES  
PËR FRYMËMARRJE  
DHE GËLLTITJE

**RUAJTJE  
NË AMBALLAZHIM TË VECANTË**

**MBETJE TË RREZIKSHME**

SIPAS LIGJIT Nr. 10463, Dt. 22. 09. 2011  
"PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË  
MBETJEVE DHE VKM Nr. 765 Dt. 07.11. 2012"  
PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR  
GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR DHE  
TRAJTIMIN E VAJRAVE TË PËRDORUR

**QENDRA PRODHUESE**

SUBJEKTI \_\_\_\_\_

ADRESA \_\_\_\_\_

TEL. \_\_\_\_\_

**DITA E FILLIMIT  
TË AMBALAZHIMIT  
DHE RUAJTJES**

**QENDRA E GRUMBULLIMIT:**

SUBJEKTI \_\_\_\_\_

ADRESA E GRUMBULLIMIT \_\_\_\_\_

TEL. \_\_\_\_\_

|  |                  |
|--|------------------|
|  | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 20 lekë